

Pranimi i Studentëve

Grupet e Synuara

➤ Studentët e rinjë

Programi u ofrohet studentëve që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe kanë kaluar Provimin e Maturës Shtetërore, të interesuar për studime universitare në fushën e gjuhës angleze, gjuhësisë, letërsisë, përkthimit dhe komunikimit intercultural. Gjithashtu, programi është i hapur për transferet e studentëve nga universitete të tjera vendore ose të huaja, për sa kohë që ato janë të licencuara dhe të akredituara nga institucionet përkatëse.

➤ Praktikantët dhe profesionistët e fushës së gjuhëve dhe komunikimit

Programi u dedikohet individëve që tashmë janë të angazhuar në fusha që kërkojnë përdorim profesional të gjuhës angleze dhe që synojnë përmirësimin e kompetencave gjuhësore, akademike dhe profesionale.

➤ Profesionistët e sektorit privat dhe publik

Programi u ofrohet profesionistëve të angazhuar në sektorë si administrata publike, biznesi, diplomaci, media, arsim, turizëm dhe organizata ndërkombëtare, ku njohja e avancuar e gjuhës angleze përbën një vlerë të shtuar profesionale.

➤ Individët e interesuar për zhvillim akademik dhe profesional ndërkombëtar

Programi u ofrohet kandidatëve që synojnë të vazhdojnë studime të avancuara (Master dhe Doktoratë) ose të ndërtojnë karrierë në mjedise akademike dhe profesionale ndërkombëtare.

Kriteret e Pranimi

Kandidatët duhet të kenë përfunduar **arsimin e mesëm të lartë**, në përputhje me Kornizën Kombëtare dhe Evropiane të Kualifikimeve.

Kandidatët duhet të kenë kaluar **Provimin e Maturës Shtetërore**, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga institucionet përkatëse.

Kandidatët duhet të demonstrojnë **njohuri bazë të gjuhës angleze**, të vlerësuara përmes rezultateve të Maturës Shtetërore ose mekanizmave të tjerë të vlerësimit të parashikuar nga UBT

dhe për të zhvilluar gradualisht kompetencat e tyre gjuhësore, akademike dhe profesionale gjatë gjithë ciklit të studimit

Kandidatët e interesuar bëjnë një aplikim online në:

<https://www.ubt-uni.net/sq/studimi/programet-bachelor/gjuhe-angleze/> dhe më pas vijnë në UBT Prishtinë për të plotësuar kërkesën për regjistrim duke bashkëngjitur dokumentet e nevojshme dhe bëjnë dorëzimin e tyre në Zyrën e Shërbimit Studentor.

Dokumentet e kërkuara gjatë aplikimit janë:

- Formulari i Aplikimit (Aplikacioni) që do të pranohet nga Zyrën e Shërbimit Studentor (SSO);
- Diploma e shkollës së mesme
- Certifikata e Përfundimit të Shkollës së mesme;
- Dëftesat e shkollës së mesme;
- Ekstrakt i Lindjes,

Programi është i hapur për studentë që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë në:

- Gjuhë të huaja,
- Shkenca shoqërore dhe humane,
- Shkenca natyrore,
- Drejtime të tjera të arsimit të mesëm të lartë.